




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/DPK
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	B-Prot.
Nr. faza	Prot. No.
Broj stranica	01-4591/12
Nr. pages	
02	Date
	Datum
	Date

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **17.12.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-4775/11, për ztr. *Naim Hasani* – ish Drejtor i Departamenit të Arsimit të lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *për shkak se nuk ekziston më situata e konflikti të interesit në ushtrimin e fuksionit të tij.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-4775-11, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se zyrtari i lartë publik ka shhangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4775-11, për Zyrtarin e lartë, ztr. Naim Hasani – tani, ish Drejtor i Departamentit të arsimit të lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtushmëri funksionesh (Neni 15 , pika 1), zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr. Hasani është paraqitur ne takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Hasani, ka dekluaruar se, ka filluar procedurat për parandalimin e konflikti të interesit, por meqense njëri nga bashkëpronarët e ati biznesi(që, sipas ztr. Hasani, në realitet vetëm është i regjistruar dhe nuk ka zhvilluar aktivitet asnjëherë), është gjerman, duhet sigurisht më shumë kohë për ta kryer këtë obligim.

Agjencionini kundër Korruptionit i ka dhënë afat të arsyeshëm për të bërë këto ndryshime, por meqense kjo ka zgjatur shumë, atëherë kemi qenë të obliguar sipas ligjit, që zyrtarit të përfshirë në këtë rast, t'i bëjmë edhe shkresën e dytë, që njihet si "Paralajmërim" (Neni 18 paragrafi 7).

Ndërkohë ztr. Hasani në Agjenci ka sjellë njoftimin se ai tashmë nuk është Drejtor i Departamentit të Arsimit të lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Këtë e ka dëshmua duke sjellë Vendimin e MASHT-it (Nr.2-4320) të datës 21.11.2012, me numër protokoli DPK-DKI-03/4433/12.

Po ashtu bashkë me këtë ztr. Hasani ka sjellur edhe një kërkesë zyrtare që i ka bërë Agjencionit kosovar për regjistrimin e bizneseve (ARBK-së) për t'i mundësuar shuarjen e tërsishme të këtij biznesi (DPK/DKI-03/4434-12).

Fakti se zyrtari i lartë, tashmë, nuk ushtron këtë funksion, mund të konsiderojmë se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të këtij dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se nuk ka pas situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni /

